

Njoftim per shtyp

TAKIMI I TRETË I PARTNEREVE TE PROJEKTIT "FOCUS"

14-15 November 2018

**Hotel Regina City,
Vlore, Albania**

Për dy ditë u zhvillua në Vlorë takimi I tretë I partnerëve të projektit "FOCUS.

Projekti "FOCUS" financohet nga fonde të Komunitetit Europian/ Programi Ballkan Med.

Projekti "FOCUS" ka startuar në Dhjetor të vitit 2017 dhe në fokus ka rritjen e konkurueshmërisë së SME - ve në fushën e agroindustrisë.

Qëllimi i projektit është që t'u ofrojë bizneseve, mundësinë e njohjes me praktikatat më të mira dhe të kooprojnë me simotrat e tyre në Greqi, Bullgari dhe Qipron Veriore.

Ditën e parë të takimit, partnerët nga Greqia, Qiprua Veriore, Bullgaria dhe Shqipëria u përqëndruan në punën e bërë deri tani në kuadër të projektit, rezultatet e arritura, aktivitetet që janë për t' u zbatuar si dhe diskutuan hapat e ardhshëm të projektit.

Dita e dytë ishte dedikuar Focus grupeve. Partnerët e projektit diskutuan mbi sektorët e agroushqimit që synojnë grupet rajonale të agroushqimit për t' u përfshirë në CLUSTER-in Ballkanik që do të krijohet në kuadër të këtij projekti. U hodhën për diskutim disa pika kyçe si: Kush do të jetë grupi i synuar i Clusterit, cilat janë format e ndryshme të shërbimeve që do të ofrohen, çfarë lloj inovacioni do të sigurohet nga Clusteri Rajonal.etj.

Ekspertë nga sfera e sektorit të bujqësisë nga Partneriteti Ballkanik i këtij projekti morrën pjesë në këtë takim, diskutuan dhe shkëmbyen pikëpamjet e tyre mbi këtë temë.

Për më tepër, Auleda_ Agjensia e zhvillimit Ekonomik lokal kishte ftuar në këtë ditë ekspertë nga ekosistemi lokal për të ndarë përvojat dhe opinionin e tyre mbi funksionimin e Clusterave Rajonale dhe për të sjell eksperiencën Shqiptare.

Z.Agim Rrapaj solli experiencën e tij disa vjeçare në sektorin e agrobujqësisë dhe Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar si dhe disa nga praktikatat më të mira që operojnë në territorin e Shqipërisë.

Z.Gramos Osmeni _Drejtor I Departamentit të Agriturës , Risi Albania, foli për sektoret kryesor të agri kulturës në Shqipëri.

Z.Alban Zusi _ Drejtor I QENDRES E EKSPORTEVE SHQIPTARE dhe përfaqesues I SHOQATES SE INDUSTRIALISTËVE USHQIMORË përcolli eksperiencën e tij mbi Klasterat duke u ndalur në klasterat e parë shqiptarë.

Balkan-Mediterranean FOCUS

Znj.Aulona Veizi _Drejtoreshë e Qendrës së transferimit të Teknologjisë, Vlorë foli për shërbimet që u ofrojnë Bizneseve që operojnë në sektorin Agro.

znj. Jonida Haxhillari _ Menaxhere e projektit EEN , Dhoma e tregtisë dhe industrisë Tiranë, ndau me të pranishmit eksperiencën e projektit që ajo kordinon në sinergji me projektin FOCUS .

Dita e dytë u mbyllë me një vizitë studimore në fabriken e Vajit të Ullirit “AULONA” në Panaja, Vlorë. Partnerët u njohën me teknologjinë e përpunimit të Vajit të ullirit, veçoritë e vajit të ullirit Kalinjot, tregun dhe prespektivën e këtij sektori.

Znj.Aulona Veizi drejtoi procesin e degustimit të vajit të ullirit me metodën e shijimit dhe nuhatjes.